



74 Vjet Fluturim dhe Lavdi – Nderim Armës së Aviacionit Shqiptar, Krenari Kombëtare



» faqe 3



SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGI URON RRUGËTIMIN 74-VJEÇAR TË KRIJIMIT TË ARMËS SË AVIACIONIT USHTARAK SHQIPTAR

Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të Forcës Ajrore! Të nderuar pilotë, ish-pilotë, teknikë dhe ish-teknikë! Kam kënaqësinë e veçantë që, në këtë ditë të rëndësishme për historinë ushtarake të vendit tonë, t'ju përcjell urimet më të sinqerta me rastin e 74 - vjetorit të krijimit të Armës së Aviacionit ushtarak shqiptar....



faqe 4




NGA KRAHËT E TRIMËRISË 74 VJET AVIACION NË SHËRBIM TË ATDHEUT

Përpjekjet e para për t'i futur aeroplanët e parë në shërbim të ushtrisë nisin aty nga fillimi i viteve 1920, me gjithë dëshirat dhe përpjekjet e disa prej drejtuesve të lartë ushtarak të asaj kohe, mundësitë ishin të pakta për "pamundësi financiare dhe buxhetore". Vetëm pas çlirimit të vendit, më 24 prill 1951, u krijuan Forcat Ajrore të ushtrisë...



faqe 5



LEXO PËR TË UDHËHEQUR: NDËRTIMI I MENDJES USHTARAKE PËRMES LIBRIT

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Data 23 prill është shpallur si Dita Botërore e Librit, më 15 nëntor të 1995, me një rezolutë të UNESCO-s, pasi u morën në konsideratë faktet se libri ka qenë, historikisht, instrumenti më i fuqishëm...



faqe 6

Objektivi i Mbrojtjes 2030: Shqipëria në hartën e vendeve të prodhimit të mjeteve, artilerisë, armatimeve, dronëve dhe municioneve

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu së bashku me kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Drejtësisë Ulsi Manja, inspektuan mjediset e Uzinës së Rubikut, e cila do të kthehet në Qendër të Industrisë Ushtarake.

Në takimin me ish-punonjës të uzinës, ministri Vengu u shpreh se ky projekt do të realizohet pas disa negociatash, të cilat janë ende në proces: “Jemi shumë afër realizimit të objektivit që qeveria shqiptare ka vendosur për rijetëzimin e industrisë ushtarake në vendin tonë. Patjetër që ky kompleks i ri ushtarak do të krijojë padyshim disa përfitime, jo vetëm për ekonominë lokale, por janë gjithashtu benefitet e logjistikës, shërbimeve mbështetëse, që do të gravitojnë rreth këtij kompleksi”, - theksoi ministri Vengu. Sipas Ministrisë të Mbrojtjes, zhvillimi i industrisë ushtarake do të hapë mjaft vende pune.

“Ne nuk synojmë të riarmatosemi, por synojmë të ngremë një ekonomi të qëndrueshme, ku industria ushtarake është një prej shtyllave kryesore të ri-industrializimit të vendit”, - u shpreh ministri Vengu.

Nga ana e tij, kryeministri Edi Rama u shpreh se: “Këtë kompleks e kemi identifikuar si një nga pikat, ku do të investohet dhe do të prodhohet për Forcat tona të Armatosura, por në masën më të madhe për eksport. Gjë që sigurisht do të thotë e para, një front i ri dhe kuptimplotë punësimi; e dyta, punësim cilësor, pasi këtu kërkohen një seri specialitetesh, ashtu sikundër edhe të gjitha kategoritë, që nga puna e inxhinierëve, tek puna e teknikëve dhe tek puna e gjithë shërbimeve mbështetëse”.

Kryeministri tha se, duke zhvilluar këtë industri nuk rriten thjesht kapacitetet tona mbrojtëse, por rritet në mënyrë të ndjeshme ekonomia vendore dhe kombëtare.

Kryeministri Rama gjithashtu theksoi se po negociohet me aleatët dhe kompani prestigjioze në fushën e Mbrojtjes, që këto investime të nisin konkretisht. “Këto qendra të industrisë ushtarake do të jenë të ndara në disa pika të terrorit sipas kapaciteteve dhe profileve të tyre dhe, do të profilizohen në prodhime të llojeve të ndryshme. Për të gjitha këto, ne jemi duke bashkëpunuar dhe negociuar me aleatë të mëdhenj të Shqipërisë, me kompanitë nga më



të mëdhatë, nga më prestigjiozet në fushën e Mbrojtjes, kemi ndërtuar rrugët e duhura për të bërë këto marrëveshje dhe së shpejti ky program do të nisë konkretisht, pas firmosjes së kontratës, këtu në Qendrën e Industrisë Ushtarake në Rubik”, - tha kryeministri Rama. Ai vuri në dukje gjithashtu se do të vijojnë investimet për mbrojtjen si dhe rritja e pagave për ushtarakët. Industria e Mbrojtjes ka një objektiv të qartë që brenda vitit 2030, Shqipëria të hyjë në hartën e vendeve të prodhimit të mjeteve, artilerisë, armatimeve, dronëve dhe municioneve. Një pjesë e godinave në kompleksin e Rubikut do të vihet në funksion të investorëve, që do të investojnë në këtë fushë.



E Ngarkuara me Punë e SHBA-ve, viziton stërvitjen “Eagle Strike 2025”, në Rreth - Greth

Në zonën e Rreth-Grethit, u ngrit kampi stërvitor në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare “Eagle Strike 2025”, me mbështetjen e plotë nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Në këtë stërvitje marrin pjesë 26 përfaqësues nga Garda Kombëtare e New Jersey-t (SHBA), 10 përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe 225 studentë dhe kadetë dhe personel mbështetës i FMS/AFA.

“Eagle Strike 2025” synon rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, forcimin e ndërveprimit mes partnerëve strategjikë dhe përmirësimin e aftësive operacionale të pjesëmarrësve në skenarë realistë të fushës. Ky bashkëpunim i ngushtë është një tregues i qartë i përkushtimit të Shqipërisë dhe aleatëve të saj për paqe, siguri dhe zhvillim të kapaciteteve të përbashkëta mbrojtëse.

E Ngarkuara me Punë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Nancy VanHorn, zhvilloi një vizitë në rajonin stërvitor të Rreth - Grethit, ku po zhvillohet prej



disa ditësh stërvitja trepalëshe “Eagle Strike 2025”.

Znj. VanHorn u shoqërua në këtë vizitë nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Altin Kurti dhe komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj.

Gjatë vizitës, përfaqësuesit e lartë u njohën nga



afër me elementët kryesorë të stërvitjes përmes një demonstrimi të drejtpërdrejtë në terren, ku u paraqitën skenarë operacionalë dhe veprime taktike. “Eagle Strike 2025” zhvillohet për të pestin vit radhazi dhe përfshin pjesëmarrjen e studentëve nga Garda Kombëtare e SHBA-së, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe studentë dhe kadetë të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Kjo stërvitje synon kompaktësimin e veprimeve në terren, ndërveprueshmërinë e forcave, si dhe rritjen e forcimin e ndërveprimit mes partnerëve strategjikë dhe përmirësimin e aftësive operacionale të studentëve.

Ceremonia e 74 – vjetorit të Forcës Ajrore, ku morën pjesë edhe zëvendëssefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Altin Kurti, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, drejtues të lartë të Forcave të Armatosura, përfaqësues nga Shoqata e Veteranëve të Aviacionit, familjarë të pilotëve dhe teknikëve të bazës, etj., u zhvillua në hangarin e sapondërtuar të helikopterëve “Black Hawk” në Bazën Ajrore të Farkës.

Në fjalën e tij në këtë ceremoni, ministri Vengu i kushtoi rëndësi përgatitjes së burrave dhe grave që shërbejnë në uniformë, trajtimit të tyre, por edhe investimeve në mjete, armatim e pajisje për Forcën Ajrore. “Objektivat pikësëpari fillojnë me kapitalin njerëzor dhe me shkollimin. Në mbledhjen e qeverisë, u ndërmorën disa hapa në këtë drejtim dhe për pak ditë do të kem kënaqësinë që t’ju ftoj përsëri në një aktivitet që do t’i vendosë vulën rithemelimit të Shkollës së Aviacionit.

Elementi i dytë ka të bëjë me modernizimin dhe investimet në mjete, pajisje, sisteme dhe ne do ta vijojmë programin e modernizimit të Forcës Ajrore. Duhet t’i rikthehemi me patjetër avionëve dhe mjeteve me krahë fikse edhe do të kemi patjetër nevojë që të shtojmë, jo vetëm pilotët përkatës, sepse do jenë në misionë të dyfishta, misionë emergjencash civile, misioni monitorimi dhe vëzhgimi. Sikundër do të vazhdojmë edhe të gjithë komponentët të mbrojtjes kundërajrore, shumë të rëndësishëm, të cilët janë neglizhuar për vite, por në kuadër të objektivave të Aleancës dhe të nevojave kombëtare, duhet që t’i rikthehemi këtij elementi shumë të rëndësishëm.

Së bashku me kapitalin njerëzor dhe modernizimin, ne do të vazhdojmë padyshim të gjithë atë përpjekje që kjo qeveri ka ndërmarrë për sa i përket trajtimit të financiar, kushteve të punës dhe benefiteve që statusi i ushtarakut jep edhe për familjet e ushtarakëve. Është bërë një përpjekje shumë e madhe. Gjatë gjithë këtyre viteve ka pasur një rritje domethënëse të trajtimit financiar të pilotëve dhe të teknikëve. Do ta vijojmë rritjen, është një zotim i kryeministrit Edi Rama, në mënyrë që të arrijmë në atë mesataren e vendeve të NATO-s, e cila nuk është arritur ende, pavarësisht se sot jemi të parët në rajon tonë”, - u shpreh ai.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, nënvizoi se hangari i ri i helikopterëve është një shembull i investimeve në infrastrukturë.

Kreu i Shoqatës së Veteranëve të Aviacionit gjeneral brigade në lirim Astrit Jaupaj solli në



74 Vjet Fluturim dhe Lavdi – Nderim Armës së Aviacionit Shqiptar, Krenari Kombëtare



vëmendje procesin e modernizimit të Forcës Ajrore si dhe falënderoi ministrin Vengu për qasjen që ka treguar në këto muaj ndaj ish - ushtarakëve. Fluturimi i parë me një avion të shtetit shqiptar u krye, më 24 prill 1951, kur piloti Peço Polena kreu fluturimin e parë, duke u bërë kështu pionier i një rrugëtimi krenarie, përkushtimi dhe kontributi të Forcave tona Ajrore.

Forcat Ajrore Shqiptare u krijuan zyrtarisht,

më 24 prill 1951. Avionët e parë ishin avionë sovjetikë të prodhuar mbas Luftës së Dytë Botërore Yak-18 dhe fillimisht u dislokuan në Laprakë në periferi të kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranë. Pak vite më vonë, Forcat Ajrore Shqiptare do të pajiseshin edhe me avionë luftarakë reaktivë. Skuadrilja e parë me avionë luftarakë MiG-15Bis, kodi i NATO-s ‘Fagot’ e titulluar “Peza” u krijua në vitin 1955. Kjo skuadrilje u dislokua në aeroportin e Kuçovës.

Në vitet e mëvonshme, në kuadrin e ndihmës ushtarake nga Bashkimi Sovjetik, Forcat Ajrore Shqiptare do të pajisen edhe me avionë luftarakë të tipave MiG-17, kodi i NATO-s ‘Fresco’ dhe MiG-19, kodi i NATO-s ‘Farmer’, dhe në fillim të viteve 70-të edhe me avionë luftarakë MiG-21 të prodhimit kinez.

Historia e Krijimit të Armës së Aviacionit është e lavdishme për gjithë rrugëtimin dhe kontributorët e saj përgjatë 74 viteve.

Certifikohen kursantët e Kursit të Avancuar të Nënoficerit të FAj

Procesi i trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit në FAj po konsolidohet dita - ditës në përputhje me standardet më të përparura. Kësaj i shërbeu edhe Kursi institucional i Avancuar i Nënoficerit, i realizuar për një periudhë 8 - javore, pas përfundimit të fazës së parë të arsimimit të përgjithshëm, të zhvilluar në QAPN në FT.

Qëllimi i këtij kursi ishte ofrimi i njohurive teorike - praktike për nënoficerët me gradën “tetar”, për promovim në gradë, si dhe për t’u aftësuar në drejtimin në nivel toge dhe niveleve të njësura me të, në specialitetin e Forcës Ajrore.

Në ceremoninë e organizuar me rastin e përfundimit të kursit, në mjediset e Qendrës Stërvitore, në Bazën Ajrore të Kuçovës, Komandanti i FAj, gjeneralmajor



Ferdinant Dimo, i përshëndeti kursantët, duke evidentuar rolin dhe rëndësinë e këtij kursi, që i shtohet rugës së gjatë të karrierës ushtarake për nënoficerët e FAj. “Në zhvillimet e fundit, Forca Ajrore ka nevojë gjithmonë e më tepër për personel të motivuar, dedikuar, mirë trajnuar e stërvitur, si dhe nënoficerë të aftësuar për të drejtuar dhe punuar në specialitetin e Forcës Ajrore”, - u shpreh gjeneral Dimo.

Programi tetë javor, ku 5 kursantë u trajnuan kryesisht në lëndët bazë të lidershipit, rregullore, ligjshmëri dhe përgatitje fizike, si dhe lëndët e specialitetit të forcës ajrore, si: taktika dhe operacionet ajrore, struktura dhe shërbimet e FAj, etj., u konkludua me dhënien e certifikatave të kursit.

Kontingjenti VIII i FD, niset në misionin e NATO-s “Aegean Sea”

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Altin Kurti mori pjesë në ceremoninë e përcjelljes së Kontingjentit VIII të Forcës Detare, në misionin e NATO-s “Aegean Sea”, në detin Egje.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu, komandanti i Forcës Detare, nënadmiralet Adnand Agastra, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, drejtorë drejtorish në SHP, familjarë e të ftuar.

Gjeneral brigade Kurti në përshëndetjen e tij drejtuar trupave, e konsideroi këtë ditë një ditë të veçantë dhe moment krenarie e përgjegjësie. “Që nga dita kur ju u betuat për t’i shërbyer atdheut, Forcës Detare, u bëtë pjesë e diçkaje më të madhe se vetja dhe tani, ndërsa përgatiteni për të nisur këtë mision, ju mbani peshën e plotë të atij premtimi. Secili prej jush është stërvitur për këtë moment, secili prej jush mban peshën e betimit, ekuipazhit dhe vendit tuaj”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kurti.

Gjeneral brigade Kurti adresoi një falënderim të veçantë edhe në emër të ministrit të Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerallejtënant Arben Kingji, ku vlerësojnë maksimalisht pjesëmarrjen dhe angazhimin e trupave në këtë mision.

Duke përfunduar, gjeneral brigade Kurti, pasi iu uroi kthim të sigurt, det të qetë dhe erëra të mbara, u shpreh se: “Mbani mend kush jeni, mbani mend se kë përfaqësoni dhe mbani mend se sado larg të lundroni, forca e plotë e vendit lundron me ju. Kryejeni misionin tuaj me nder dhe kthehuni, duke ditur se keni bërë atë që pak kush mund ta bëjë...”.

Kontingjenti VIII i Forcës Detare është përshëndetur dhe nga komandanti i Forcës Detare,



në admiralet Adnand Agastra, i cili pasi vlerësoi profesionalizmin e efektivëve, theksoi se FD po transformohet për të përmirësuar operacionet dhe ndërveprueshmërinë me vendet partnere të Aleancës. “Përveç pjesëmarrjes në operacionet e ‘Sea Guardian’, ‘FOCOPS’, ne po përgatitemi të gjerim angazhimin tonë në rajonin e Detit të Zi dhe të ASPIDES, opsion i BE në Detin e Kuq, duke demonstruar përkushtimin tonë për të shërbyer si një partner i besueshëm në arkitekturën globale të sigurisë”.

Ceremonia u përmbyll me dorëzimi e flamurit kombëtar nga komandanti i Forcës Detare nënadmiralet Agastra, komandantit të Kontingjentit VIII të misionit “Aegean Sea”, kapitenit të rangut III, Elton Kasemi.



Përfundoi operacioni për vlerësimin dhe largimin e municioneve të rrezikshme në njësinë administrative Dajt, bashkia Tiranë

Batalioni i Xhenios i është përgjigjur thirrjes së autoriteteve të emergjencave civile në bashkinë Tiranë, në lidhje me municionet e gjetura në parcelën e një fermeri në fshatin Priskë e Madhe, njësi administrative Dajt.

Një ekip specialistësh të kompanisë EOD, u dislokuan në zonën e operacionit dhe, pasi bënë identifikimin dhe vlerësimin e municioneve të gjetura, konstatuan se ishin granata dore të prodhimit italian dhe fishekë të kalibrave të ndryshëm.

Municionet u vlerësuan të prekshme dhe të lëvizshme dhe u transportuan për magazinim, duke respektuar të gjitha masat e sigurisë.

Efektivët e Batalionit të Xhenios bënë të mundur pastrimin e zonës, duke kontribuar për sigurinë e jetës së banorëve dhe pronës së tyre.

Qendra e Simulimit të Qitjeve me Armët e Këmbësorisë, një kapacitet i ri në Forcën Tokësore

Në Qendrën Stërvitore të Komandës së Forcës Tokësore përfundoi Kursi i Instruktorëve për Përdorimin e Simulatorit të Qitjeve me Armët e Këmbësorisë.

Ky simulator, i prokuruar përmes ODC me programin FMS (Foreign Military Sales), përfaqëson një kapacitet të ri për Forcën Tokësore.

Në demonstrimin e përfundimit të këtij trajnimi, ku u certifikuan 3 instruktorë, morën pjesë një ekip nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit për Mbrojtjen si dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Gjeneralmajor Xhebexhia, pasi falënderoi specialistët amerikanë për montimin dhe trajnimin e përdorimit të këtij simulatori, theksoi përfitimet e rëndësishme që sjell ky kapacitet i ri në trajnimin e efektivëve, duke ndihmuar në krijimin dhe ruajtjen e aftësive në qitjet luftarake.



Certifikohen gjashtë kursantë në kursin e Topografisë, në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore

Në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore u zhvillua kursi funksional i Topografisë. Në të morën pjesë 13 kursantë, të cilët zhvilluan tema të ndryshme të tilla si: studim terreni, instrumentet orientuese, traversë ditën, traversë natën, topografi etj.

Ky kurs lindi si domosdoshmëri e trajnimit të herëpashershëm për ruajtjen dhe rritjen e aftësive në Topografi. Në përfundim të këtij kursi vetëm 6 më të mirët u certifikuan si një tregues i qartë i cilësisë dhe standardit të lartë që kjo Qendër mban dhe reflekton.

SHSHHPFA, gjeneralallejtënant Arben Kingji uron rrugëtimin 74-vjeçar të krijimit të Armës së Aviacionit ushtarak shqiptar

Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të Forcës Ajrore!
Të nderuar pilotë, ish-pilotë, teknikë dhe ish-teknikë!
Kam kënaqësinë e veçantë që, në këtë ditë të rëndësishme për historinë ushtarake të vendit tonë, t’ju përcjell urimet më të sinqerta me rastin e 74 - vjetorit të krijimit të Armës së Aviacionit ushtarak shqiptar.

Kjo është një ditë reflektimi dhe krenarie, ku ne nderojmë me respekt të thellë punën, përkushtimin dhe profesionalizmin e çdo efektivit që ka shërbyer e shërben në këtë armë elitare të Forcave të Armatosura.

Kjo ditë nuk është vetëm një përvjetor përkujtimor, është një ditë që na rikujton rrënjët nga ku nisëm, sfidat që kemi kapërcyer dhe rrugën që na pret përpara.

E nisur nga fluturimi historik i pilotit Peço Polena, në ish-fushën e Laprakës, e ndërtuar hap pas hapi me pasionin dhe përkushtimin e brezave, Forca Ajrore është shndërruar në një shtyllë të sigurisë kombëtare dhe një mbështetje thelbësore për operacionet e Forcave të Armatosura dhe për institucionet civile në raste emergjencash natyrore dhe shëndetësore.

Forca Ajrore është një simbol i besimit të shtetit shqiptar në mbrojtjen, përgatitjen dhe përgjegjësinë, një pasqyrim i përkushtimit për sigurinë e vendit dhe për ndërtimin e një Shqipërie që qëndron me dinjitet në krah të aleatëve të saj euroatlantikë.

Në çdo mision fluturimi, qoftë për stërvitje, qoftë për në ndihmë të popullsisë në rastet e emergjencave civile, operacione kërkim-shpëtimi apo evakuimi mjekësor (MEDEVAC), ju jeni një angazhim konkret për sigurinë e qytetarëve dhe një dëshmi e gatishmërisë sonë në të gjitha nivelet e përgjegjësisë.

Në një mjedis gjeopolitik të pasigurt, ku paqja sfidohet përditë nga zhvillimet afër dhe larg nesh, që nga lufta në Ukrainë, tensionet në Lindjen e Mesme e deri te dinamika në rajonin e brishtë të Ballkanit, ne jemi të ndërgjegjshëm se siguria nuk merret më si e mirëqenë, por një detyrë që kërkon vigjilencë, partneritet të ngushtë dhe kapacitete të gatshme për përgjigje.

Në këtë kontekst, modernizimi i mëtejshëm i Forcës Ajrore nuk është një zgjedhje, por një domosdoshmëri dhe një nga prioritetet kryesore të FARSH në përgjigje të sfidave të sigurisë.

Sot, jemi dëshmitarë të një transformimi të prekshëm, të një force të ristrukturuar, e cila po modernizohet me ritëm dhe po rrit kapacitetet e saj në përgjigje të kërkesave kombëtare dhe në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe standardet e NATO-s.

Ky transformim po vijon me Bazën Ajrore Taktike Kuçovë, e cila jo vetëm do të përforcojë kapacitetet ajrore, por do të shërbejë si nyje e rëndësishme për operacionet e stërvitjeve të përbashkëta dhe mbështetjes logjistike të Aleancës.

Dronët luftarakë të gjeneratës së fundit, tashmë të përfshirë në doktrinat tona ushtarake, kanë zgjeruar aftësitë e vëzhgimit, goditjes precize dhe mbështetjes taktike të trupave të manovrës.

Në këtë kuadër, përveç investimeve në trajnimin dhe kualifikimin e efektivave, po fuqizojmë flotën ajrore me helikopterë “Black Hawk”, të cilët do të rrisin aftësitë e manovrës taktike, transportit, emergjencave dhe misioneve në ndihmë të popullsisë, në gjithë territorin e vendit.

Kapaciteteve aktuale do t’i shtohet flota e avionëve të lehtë taktikë, me përdorim të dyfishtë, jo vetëm për trajnimin e pilotëve të rinj dhe për mbështetjen ajrore të trupave, por edhe për emergjencat civile, etj., si dhe sistemet e mbrojtjes ajrore.

Krahas investimeve në sisteme dhe pajisje, do të vijojmë edhe investime të mëtejshme në infrastrukturën kritike stërvitore dhe logjistike në bazat ajrore Farkë, Kuçovë dhe Gjadër, do të përmirësojmë ambientet e punës, jetesës dhe trajnimit, duke siguruar kështu një bazë solide për operacione të suksesshme në të ardhmen.



Të gjitha këto nuk janë thjesht përmirësime teknologjike, ato janë investime në besueshmërinë tonë si vend aleat dhe në garancinë që Shqipëria është e gatshme të mbrojë sovranitetin e saj ajror. Këto janë hapa të vendosur drejt shndërrimit të një Forcë Ajrore moderne, të gatshme për përpalljen me sfidat e sigurisë së të ardhmes.

Të dashur pilotë dhe teknikë, aktivë dhe në lirim!

Në këtë përvjetor të 74-t, është detyrë e jona të nderojmë dëshmorët e Aviacionit, dhe të kujtojmë me mirënjohje të thellë të gjithë ata që me përkushtim e sakrificë, ndërtuan këtë forcë nga themelet. Pilotë vizionarë, teknikë të palodhur, instruktorë, operator sistemesh zbuluese e reaguese, kontrollorë të trafikut



ajror, të gjithë ata që kontribuan në çdo hallkë të kësaj strukture strategjike, janë pjesë e një trashëgimie që duhet ruajtur e zhvilluar më tej.

Ju jeni më shumë se ushtarakë, jeni simboli i besimit, disiplinës dhe profesionalizmit që i jep forcë flamurit tonë kombëtar. E ardhmja e Forcës Ajrore do të ndërtohet nga përkushtimi, guximi dhe vullneti juaj.

Duke përfunduar, ju inkurajoj të ecim përpara me vendosmëri dhe vizion, për të ndërtuar një Forcë Ajrore moderne, shumë funksionale dhe të gatshme për çdo sfidë që e ardhmja mund të sjellë.

Në emër të Forcave të Armatosura, ju falënderoj për gjithçka që keni bërë dhe vazhdoni të bëni për këtë armë elitare! Respekt për brezat që ndërtuan, dhe besim të plotë në ata që do të fluturojnë më lart për Shqipërinë e së nesërmes.

Nga krahët e trimërisë -74 Vjet Aviacion në Shërbim të Atdheut



Përpjekjet e para për ti futur aeroplanët e parë në shërbim të ushtrisë nisin aty nga fillimi i viteve 1920, me gjithë dëshirat dhe përpjekjet e disa prej drejtuesve të lartë ushtarak të asaj kohe, mundësitë ishin të pakta për “pamundësi financiare dhe buxhetore”.

Vetëm pas çlirimit të vendit, më 24 prill 1951, u krijuan Forcat Ajrore të ushtrisë shqiptare, që ne sot i njohim si pasojë e faktorëve historikë dhe politike, që mundësuan krijimin e Aviacionit Ushtarak. Pozita e favorshme gjeostrategjike e Shqipërisë në krahun juglindor të Evropës favorizonte synimet e Bllokut Lindor e sidomos të ish-Bashkimit Sovjetik, për daljen e tij në ujërat e Adriatikut dhe Mesdheut Qendror, për krijimin e bazave aerodetare. Për këtë sovjetikët morën përsipër të gjitha angazhimet për ta futur Shqipërinë në Traktatin e Varshavës. Ana morale-politike konsistonte në instalimin e vlerave komuniste pro lindore në Shqipëri dhe inkuadrimin e saj në të ashtuquajturën bashkësi të shteteve të demokracive popullore të Evropës Lindore. Po kaq të rëndësishme ishin roli dhe aftësia e udhëheqjes politike e ushtarake të shtetit shqiptar, e cila i shfrytëzoi këto konjuktura politike e ushtarake për forcimin e mbrojtjes së Shqipërisë. Pas kësaj u krijuan kushtet që ushtria jonë të riarmatosej me shpejtësi, duke u pajisur me teknikën luftarake moderne të kohës dhe formimin e Aviacionit e të Ushtrisë Shqiptare.

Aviacioni ynë u formua në rrethana tepër të veçanta, pothuajse në një vend të zbrazët, pa një infrastrukturë të përgatitur, pa tradita dhe pa eksperiencën e nevojshme në këtë fushë. Ne kishim një varg mungesash në fushën e shfrytëzimit të teknikës, sidomos për pjesë këmbimi e materiale konsumi, mungonte baza e nevojshme e riparimit fushor të teknikës, ndërsa prapavija e aviacionit mungonte pothuajse krejtësisht.

Në vitet 1945-1955, Shqipëria ishte shndërruar në një arenë të mbikalimeve të shumta e të pakontrollueshme të aeroplanëve të huaj ushtarakë dhe civilë, ndaj kërkoheshin masa urgjente dhe efektive për mbrojtjen e dimensionit të tretë, atij të hapësirës ajrore, e cila paraqitej më e dobët e tepër delikate, krahas mbrojtjes së kufijve tokësorë e detarë.

Në këtë kohë u shtrua për zgjidhje një problem me karakter strategjik, krijimi i forcave ushtarake kundërajrore, që do të përfshinin: Aviacionin Luftarak, Artilerinë e Mbrojtjes Kundërajrore dhe mjetet e zbulimit të hapësirës ajrore, të drejtuara nga një staf drejtues. Komanda e MKA-së së Shtetit, si lloji i veçantë i forcave të armatosura për mbrojtjen e sovranitetit të shtetit shqiptar.

Gjeneratës së parë të aviatorëve shqiptarë, në vitet 1954-1955, i takoi rasti historik që të hapin erën e aeroplanëve reaktivë në Shqipëri. Pas këtyre viteve filloi funksionimi normal i aviacionit sipas standardeve bashkëkohore dhe ingranimi i tij në hallkat e sistemit të mbrojtjes ajrore. Filloi një epokë e re e zhvillimit, nga më intensivet e përgatitjes luftarake, fillimisht për përvetësimin e aeroplanëve reaktivë, kompaktësimi brenda vetes dhe me trupat e MKA-së dhe më pas në kuadrin e Forcave të Armatosura në tërësi, me detyrën për mbulimin dhe sigurimin e veprimeve luftarake të Forcave Tokësore dhe Flotës Luftarake Detare, në drejtimet kryesore operative dhe për barazimin e vlerave tona me FUA-të e vendeve të Bllokut Lindor. Në sajë të një përgatitjeje ajrore intensive dhe të organizuar mirë, pilotët tanë kishin nivele të krahasueshme me aviatorët e vendeve të tjera. Këtë e dëshmojnë sukseset në drejtim të mbrojtjes së hapësirës ajrore të vendit. Mjaft pilotë trima dhe figura të spikatura lanë emër në historinë e aviacionit: Kosta Dede nga Vunoi i Himarës, Anastas Ngjela, nga Sheperi i Zagorisë, Mahmut Hysa nga Maminasi i Durrësit. Më pas, pilotët Koco Biku dhe Gëzdar Veipi treguan një përgatitje luftarake të lartë, guxim e trimëri, pjekuri e gjakftohtësi, si dhe korrektësi në zbatimin e instruksioneve për rastet e shkeljeve të hapësirës ajrore nga dhunuesit e huaj. Aviacioni ynë tregoi edhe përpara opinionin ndërkombëtar se Shqipëria ka zot shtëpie dhe askujt nuk i lejohet ta shkelë sovranitetin ajror të saj. Për veprimet e tyre të vendosura e të guximshme ata u dekoruan me ‘Urdhrin e Lartë Luftarak të Trimërisë’, ose merituan vlerësimin më të lartë të Komandës së Përgjithshme.

Në vitin 1959, aviacioni ynë u pajis me aeroplanë reaktive supersonikë interceptues, për kryerjen e detyrave luftarake në të gjitha kushtet meteorologjike dhe u armatos me raketa ajër-ajër. Kështu, u çel në Shqipëri era e aeroplanëve superzanorë. Aviatorët e gjeneratës së dytë treguan aftësi të lavdërueshme profesionale si në përvetësimin e këtyre aeroplanëve, ashtu edhe në qitjet luftarake me raketa ajër-ajër, duke zënë vendin e dytë ndërmjet vendeve të Aleancës Lindore. Ata u bënë mjeshtër të përvetësimit të teknikës supersonike, zotëruan dhe aeroplanët më moderne MIG-21, duke u bërë komandantë të zotë dhe instruktorë në përvetësimin e kësaj teknike edhe për kuadrot pasardhës të aviacionit.

Një respekti veçantë i takon efektivit të Regjimentit të Helikopterëve dhe Skuadriljes së Transportit. Ata

meritojnë vlerësimin më të lartë për shërbimet që i kanë sjellë ushtrisë dhe popullatës civile. Në këto reparte janë përgatitur me qindra parashutistë të njësive tona operative. Por ato dhanë një kontribut të madh edhe në elektrifikimin e plotë të vendit, spërkatjen e mijëra hektarëve tokë bujqësore, apo kryen akte të guximshme në raste përmbytjesh e fatkeqësish natyrore.

Jetëshkrimi i aviacionit tonë luftarak është historia e çdo ushtaraku, piloti, tekniku e specialisti. Mirënjohje për përpjekjet e panumërta dhe përkushtimin e tyre maksimal, si dhe për sakrificat më sublime që kanë dhënë ata për mbijetesën e aviacionit.

Mbështetur mbi këtë efektiv të pas viteve 1961, Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë u dha rrugëzgjidhje shumë problemeve të mprehta, që lindën e pasuan pas prishjes së marrëdhënieve të vendit dhe të ushtrisë sonë me Traktatin e Varshavës. Aviacionit tonë iu ndërpre në të gjitha furnizimet me karburant, për pjesë këmbimi e materiale konsumi, municione, remontin teknik etj. U ndërpre edhe përgatitja dhe shkollimi i kuadrove fluturuese dhe inxhiniero-teknik, si edhe një sërë projektesh të filluara. Ndryshimi i kahut të politikës shqiptare dhe orientimi i saj drejt Republikës Popullore të Kinës ishte zgjidhja e kohës.

Sot ne kemi të drejtën legjitime që të krenohemi me këtë institucion të rëndësishëm të aviacionit luftarak, nga dyert e të cilit, për dekada kanë dalë kuadro të kualifikuar, që mbajtën mbi supet e tyre gatishmërinë luftarake.

Në periudhën 1961-1978, në mënyrë graduale, u krijuan tre regjimente të aviacionit gjuajtës dhe gjuajtës-bombardues të strehuar në tunele, një regjiment helikopterësh MI-4, një skuadrilje autonome e transportit ushtarak AN-2, u kompletua shkolla e aviacionit me aeroplanë luftarako-mësimorë dhe me të gjitha mjetet e nevojshme mësimore didaktike dhe detashmenti i avionëve qeveritare IL-14. U ndërtua uzina e riparimit kapital të aeroplanëve dhe helikopterëve, filloi prodhimi i pjesëve të këmbimit dhe më pas edhe riparimi kapital i motorëve të aviacionit. Në Republikën Popullore të Kinës u specializuan rreth 150 pilotë luftarake për drejtimin e aeroplanëve supersonikë MIG-19 dhe MIG-21. Dhjetëra pilotë të rënë në lulen e rinisë mbetën të përgjeshëm si martirë të ajrit, si bij të paharruar të atdheut. Dhjetëra dhimbje njerëzore mbetën të pashlyera në zemrat tona. Të gjitha këto u bënë në emër të mbrojtjes së atdheut.

Veteranët e aviacionit, punuan, luftuan dhe sakrifkuan në rrethanat e një konfrontimi politiko-ushtarak të dy blloqeve kundërshtare, në kushtet e një gare të shfrenuar të armatimeve, mes një ankthi të madh të luftës së ftohtë, nën një tension nervor të skajshëm dhe plot mobilizim të forcave materiale e shpirtërore të popullit, sidomos të efektivave të forcave të armatosura. Pohojmë pa mëdyshje se 60 vitet e ekzistencës së aviacionit tonë janë një periudhë e lavdishme në historinë e zhvillimit të Forcave të Armatosura. Sot ne jetojmë në kushte e rrethana krejtësisht të ndryshme e të pakrahasueshme me të kaluarën. Shqipëria ka hequr dorë nga vetë-izolimi. Tani jemi inkuadruar në NATO dhe organizma të tjera evropiane. Ndërtimi i ushtrisë moderne e të pajisur me teknikë bashkëkohore, sidomos për një vend të vogël si Shqipëria, është pa dyshim një barrë e rëndë për ekonominë, por ajo është njëherazi domosdoshmëri për interesat e mbrojtjes së vendit.

Ndaj, për t’u afirmuar, në kuadrin e NATO-s, duhet të bëhemi të barabartë me partnerët e tjerë të aleancës Euro-Atlantike, në përgatitjen teknike e luftarake, të thithim idetë më të mira të kolegëve perëndimorë, ta ngremë në ideal traditën tonë të aviacionit, duke bërë shndërrimin rrënjësor të Forcës Ajrore Shqiptare dhe të krijojmë elitën e re të aviacionit tonë në të gjitha fushat e kësaj arme, sa delikate aq edhe të rëndësishme për atdheun, e cila do t’i plotësonte fondet me shumën prej 10.000 franga ari, aq sa kushtonte avioni. Në një artikull të datës 10 mars 1921, në gazetën “Shqiptari”, që botohej në Rumani, në faqen 3 thuhet: Në një letër që na vjen nga Parisi na lajmëron se atje po presin këto ditë të vijnë nga Shqipëria tre shqiptarë për të mësuar në shkollë për aviatorë. Shprehim se të tjerë do të vijnë pas tyre për të mësuar në Paris”.

Në prizmin organizativ shtetëror, që në nëntor të vitit 1929, në Shqipëri u dekretua “Ligji mbi organizimin e Fuqive Armate”, ku ushtria emërtohej “Ushtria Kombëtare Shqiptare” dhe organi më i lartë drejtues i saj ishte Komanda e Mbrojtjes Kombëtare. Sipas këtij ligji, ushtria ndahej në tri lloje forcash: Tokësore, Detare dhe Ajrore. Megjithatë, Forcat Ajrore nuk arritën të jenë funksionale asnjëherë para Luftës së Dytë Botërore, ndonëse ato ekzistonin në tri dekrete ligjet, që u miratuan dhe u vunë në zbatim edhe në vitet 1931, 1934 dhe 1937 nga mbreti Ahmet Zogu, kryesisht për pamundësinë financiare, për këto arsye, në atë kohë u gjykua që Forcat Ajrore ose “Fuqitë Aerore”, siç i quante dekretligji, të lireshin dhe të formoheshin në varësi të “disponibilitetit të buxhetit” me një ligj të veçantë.

Por forma më e organizuar e përgatitjes së efektivave të aviacionit ka filluar pas Luftës së Dytë Botërore, kohë në të cilën Shteti Shqiptar dërgoi në ish- Jugosllavi kontingjentin e parë dhe, pothuajse njëkohësisht, edhe në ish-Bashkimin Sovjetik. Në prill të vitit 1945, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare, u krijua Seksioni i Aeronautikës, me qëllim që të kryhej sigurimi i aerodromeve dhe vënia në funksionim e aeroportit të Tiranës për pritjen e avionëve në këtë aerodrom. Në këtë grup bënë pjesë ish-partizanë, si zëvendëskomandanti i Brigadës së Tretë, Kapiten Ernest Jakova, shefi kësaj dege, si dhe togerët Mahmut Agolli e Hysen Brovina.

Fillimet e tij, Aviacioni Luftarak Shqiptar i ka pas ardhjes së avionëve JAK-9P (Jakovljev), në muajin mars të vitit 1951, kur në Laprakë u formua reparti i parë. Struktura e këtij reparti ishte e para formë e organizuar e Aviacionit Shqiptar. Gjithçka ishte shqiptare, pilotët, grupi inxhiniero-teknik, mbështetja logjistike, ndërlidhja, Regjimenti i Helikopterëve u formua në dhjetor 1967. Ai kishte në organikën e tij tri skuadrilje me 36 helikopterë MI-4. Baza Ajrore e Gjadrit është formuar e fundit në repartet e aviacionit. Ajo u krijua në shkurt të vitit 1974 dhe ishte një bazë tërësisht e tunelizuar, e cila kishte dy skuadrilje MIG-19 dhe një skuadrilje MIG-21.

Aviacioni Luftarak Shqiptar në atë kohë numëronte mbi 200 avionë e helikopterë, të cilët që të gjithë ishin të prodhimit lindor.

Aviacioni Luftarak Shqiptar kishte për detyrë “Mbrojtjen e paprekshmërisë së kufijve shtetërorë të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Që nga krijimi i repartit të parë e deri në vitin 1974, aviacioni ishte një strukturë brenda Mbrojtjes Kundër Ajrore të shtetit. Komandanti i aviacionit është emëruar



për herë të parë në vitin 1955, në krye të aviacionit u caktua Edip Ohri, i cili njëkohësisht ishte edhe zëvendëskomandant i MKA-së.

Në vitin 1974 aviacioni u sanksionua si komandë më vete dhe si e tillë ka qëndruar deri në vitin 1995.

Në vitin 1995 repartet e aviacionit u bënë pjesë e Forcave të Mbrojtjes Ajrore, një strukturë që përmblihte MKA-në, aviacionin, Regjimentin Radio/Teknik.

Në krye të Forcave të Mbrojtjes Ajrore drejtuan gjeneral Perlat Sula dhe gjeneral Agim Baruti.

Në Kushtetutën e Republikës Së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998, u përcaktua se: “Forcat e Armatosura përbëhen nga Forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore”. Me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, datë 08.04.2000, “Për fillimin e ristrukturimit të Forcave të Armatosura të Republikës Së Shqipërisë”, doli urdhri i ministrit të Mbrojtjes, “Për kalimin në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore”. Në 18 gusht të vitit 2000, me dekret të Presidentit të Republikës, Nr.2733, datë 11.08.2000, komandant i Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë u emërua kolonel Astrit Jaupi (gjeneral brigade në vitin 2001).

Aviacioni Shqiptar ka të ardhme të madhe

Sipas mitologjisë, Ikari, njeriu i parë që “sulmoi” qiellin me disa flatra të ngjitura në shpine, u nis në aventurën më të çmendur për të realizuar të pamundurën, sfidën e njeriut ndaj perëndive, fluturimin, por, në lartësitë e mëdha, dielli e shkriu dyllin, me të cilin Ikari kishte ngjitur krahët. Ndodhi kështu “katastrofa” e parë ajrore, e cila nxori në pah faktin se “teknologjia” do të kishte historikisht rolin e vet në fatin e ëndrrave e projekteve të mëdha të njerëzimit në sulmin ndaj qiellit.

Ikari vdiq, por nuk vdiq ëndrra e njerëzimit për të fluturuar, legjenda mbeti e gjallë mes brezave të shoqërisë njerëzore, sfida ndaj qiellit mbeti e hapur deri në realizimin e saj pas mijëra vjetësh.

Prej rreth 100 vjetësh, që nga shpikja magjike e vëllezërve Rajt në Amerikë, kur u shpikën avionët, makinat fluturuese më të rënda se ajri e deri më sot, kur nga Kep Kenedi nisen mjetet më moderne që “sulmojnë” kozmosin, “dylli i krahëve të Ikarit” shpesh ka pësuar “shkrirje”, teknologjitë kanë treguar kështu dobësitë e veta. Me gjithë evolucionin e jashtëzakonshëm shkencor, teknologjia e zbatimit të projekteve dhe ëndrrat e mëdha nuk kanë mundur të ecin krah për krah. Hekura, tela, termometra, aparatura e matës nga më të ndryshmit, me tekat e shpërfilljen e tyre pa ndjenja, e kanë sfiduar ëndrrën e njerëzimit për fluturim, kanë tentuar ta shkurajojnë guximin e atyre që sfidojnë epokat dhe periudhat tranzitive, ecjen përpara në këtë fushë.

Mijëra heronj të ëndrrës fluturuese të njerëzimit kanë hedhur gurin e tyre në “kështjellën” e dijeve njerëzore, për t’i dhënë shansin brezave pasardhës të kuptojnë e ndreqin gabimet, për t’u dhënë atyre shansin e ecjes përpara dhe të kuptojnë se ku janë afatet. Aviacioni Luftarak ka lënë kujtimin e dëshmorëve, të cilët janë krenaria dhe nderi i kësaj arme, simboli i mënyrës se si i duhet shërbyer shtetit, me një përkushtim që nuk merr parasysh as sakrificat sublime, gjë që përbën një shembull edhe për brezat e sotëm në devotshmërinë karshi vendit.

Në aviacion kanë rënë në krye të detyrës shumë “Dëshmorë të Atdheut”, mosha mesatare e të cilëve është 31 vjeç. Si në çdo luftë ku marrin pjesë heronj të vërtetë, ata që bien janë dëshmorët, siç janë pa asnjë diskutim edhe dëshmorët e aviacionit. Të shtrirë mbi shtratin e topit, të mbështjellë me flamurin kombëtar, në ritmet e përzishme të marsheve funebre, ata u nisën drejt përjetësisë, për në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, aty ku vargjet e himnit tonë, “po vdes, po vdes, si një dëshmor”, marrin një kuptim real e krejt të veçantë. Aktualisht, repartet e Aviacionit janë pjesë shumë e rëndësishme e Forcave Ajrore të Shqipërisë. Misioni i kësaj force, teknika e ardhur dhe ajo që pritet të vijë nga ushtritë mike e aleate si dhe kualifikimi bashkëkohor i personelit të tij bën që planet e zhvillimit të parashikojnë modernizimin e mëtejshëm, në mënyrë të

tillë që nivelet operacionale të saj të rriten vazhdimisht.

Në përpjekjet e vazhdueshme që bëhen në Forcat Ajrore të Shqipërisë për kualifikimin e tyre të mëtejshëm, krahas arsimimit dhe kualifikimeve në shkollat aktuale ushtarake të vendin tonë e po kështu edhe të atyre perëndimore, bëhen përpjekje të lavdërueshme për të përvetësuar edhe nga përvoja e trashëguar nga profesionistët dhe historia e reparteve të dikurshme të Aviacionit Luftarak Shqiptar.

Aviacioni është një armë krenare, moderne e bashkëkohore, por e vështirë dhe e rrezikshme. Kjo armë kërkon që njerëzit që punojnë aty jenë të emancipuar e të përgatitur shumë mirë profesionalisht, të kenë pasion e përkushtim të veçantë dhe këta njerëz Shqipëria i ka; aviacionit i duhen njerëz me eksperiencë shumë të vyer të personelit, pilotë, teknikë dhe reparte mbështetëse, dhe Shqipëria i ka; aviacioni është një armë që kushton shtrenjtë, dhe aviacioni ka mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por edhe të ushtrive partnere e aleate të NATO-s. Historia e aviacionit në mbarë botën është një histori e guximtarëve, e pionierëve të ecjes përpara, e ëndrrave të njeriut për sfidat e mëdha të zhvillimeve e transformimeve epokale. Edhe aviacionit tonë nuk i kanë munguar as heronjtë



që i përcillnin këto ndryshime. Aviacioni i vendit tonë është arma e vështirë dhe e lavdishme, është simboli i gatishmërisë më të lartë për t’i shërbyer vendit, emblema e përkushtimit për detyrën e profesionin. Aviatorët, ashtu si njerëzit e profesioneve me rrezik të lartë në përgjithësi, janë pionierët e zbulimeve njerëzore e të ndryshimeve teknologjike, janë përfaqësuesit e thjeshtë që realizojnë të pamundurën, atë që mbase duam të bëjmë të gjithë, e që nuk e bëjmë dot për njëmijë arsye, janë pjesë e asaj shtrese të shoqërisë që simbolizon kurajën dhe luftën për ëndrra të mëdha.

Brezat paraardhës të Aviacionit Luftarak, me ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë në zbatimin e detyrave, me eksperiencën e madhe e të çmuar që kanë lënë pas për brezat e ardhshëm, me krenarinë që i kanë dhënë aviacionit e Forcave të Armatosura, janë pa diskutim një vlerë e madhe kombëtare.

Aviacioni ynë Luftarak ishte një armë, një shërbim, një institucion i organizuar më së miri, teknika që ai pati në përdorim në ato vite ishte nga më prestigjiozet për kohën, e mirë dhe e krahasueshme si e mjaft shteteve rreth e


rrotull vendit tonë. Njerëzit që e drejtuan e menaxhuan atë u treguan të aftë për ta administruar, për ta vënë në përdorim në mënyrë shkencore, megjithëse ishte një teknikë e shkence bashkëkohore, gjë që edhe sot i bën ata të ndihen krenarë për detyrat e realizuara. Pilotët e teknikët që i shfrytëzuan në vite avionët e helikopterët e Shtetit Shqiptar, me eksperiencën e madhe e të çmuar që kanë lënë pas, mbeten një vlerë kombëtare për ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në zbatimin e detyrave të caktuara.

Forcat Ajrore të Aviacionit janë simbol i bashkëpunimit me ushtritë aleate, prej të cilit ka arritur rezultate konkrete transformuese. Ky bashkëpunim, i bazuar në Strategjinë e Sigurimit Kombëtar, i jep përparësi marrëdhënieve me partnerët strategjikë, të cilët kanë kryer investime të rëndësishme, kanë trajnuar ushtarakët tanë, kanë kryer investime serioze, apo kanë ndihmuar në realizimin e stërvitjeve e përbashkëta, ku ky bashkëpunim ka pasur efekte reale. Stema e Forcave Ajrore paraqet në mënyrë skematike mburojën mbrojtëse të luftëtarit, në fushën blu brenda së cilës, në një rrip të bardhë janë paraqitur tre avionë luftarakë supersonikë. Fusha blu e stemës sonë simbolizon qiellin, rruga e bardhë ku janë vendosur avionët simbolizon paqen, ndërsa vendosja në këtë fushë e tre avionëve luftarakë supersonikë, zhvillimet në të ardhmen e Forcave Ajrore.

Në historinë e njerëzimit ka ndodhur ajo që, atje ku ka ngulur flamurin ushtria, aty një komb ka pasur syrin e shpirtin, atje një shtet ka pasur kufirin dhe kjo, me sa duket, nga fakti se ushtria dhe ushtarakët janë një pjesë përfaqësuese dhe emblematike e tyre, ndërsa flamuri, simbolika e të gjitha politikave e interesave. Aviacioni është ai që e ngre në qiell flamurin e Shqipërisë. Stema e Forcave Ajrore paraqet në mënyrë skematike mburojën mbrojtëse të luftëtarit, në fushën blu brenda së cilës, në një rrip të bardhë janë paraqitur tre avionë luftarakë supersonikë. Fusha blu e stemës sonë simbolizon qiellin, rruga e bardhë ku janë vendosur avionët simbolizon paqen, ndërsa vendosja në këtë fushë e tre avionëve luftarakë supersonikë, zhvillimet në të ardhmen e Forcave Ajrore, Në historinë e njerëzimit ka ndodhur ajo që, atje ku ka ngulur flamurin ushtria, aty një komb ka pasur syrin e shpirtin, atje një shtet ka pasur kufirin dhe kjo, me sa duket, nga fakti se ushtria dhe ushtarakët janë një pjesë përfaqësuese dhe emblematike e tyre, ndërsa flamuri simbolika e të gjitha politikave e interesave. Aviacioni është ai që e ngre në qiell flamurin e Shqipërisë.

**ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve

Lexo për të Udhëhequr: Ndërtimi i mendjes ushtarake përmes Librit



Data 23 prill është shpallur si Dita Botërore e Librit, më 15 nëntor të 1995, me një rezolutë të UNESCO-s, pasi u morën në konsideratë faktet se libri ka qenë, historikisht, instrumenti më i fuqishëm i shpërndarjes së njohurive dhe mjeti më efikas për të siguruar ruajtjen e këtyre njohurive, se çdo nismë për promovimin e librave të rinj është një faktor i pasurimit kulturor etj. Ideja e përkujtimit të Ditës Botërore të librit e ka origjinën e vet në Spanjë, në zonën e Katalonjës, ku atij që blinte një libër i dhurohej edhe një trëndafil.

Më 23 prill të vitit 1616, u nda nga kjo botë Servantesi, Shekspiri dhe Garcilaso de la Vega, i mbiquajtur Inca. 23 prilli shënon edhe lindjen ose vdekjen e shkrimtarëve të tjerë, si Maurice Druon, K.Laxness, Vladimir Nabokov, Joseph Pla dhe Manuel Mejia Vallejo. Kjo është arsyeja, për të cilën kjo datë domethënëse për letërsinë universale është caktuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, për t'i bërë homazh botëror librit dhe autorëve të tij dhe për të inkurajuar të rinjtë, që të zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit, si edhe për të respektuar kontributin e pazëvendësueshëm, që kanë dhënë krijuesit për progresin social dhe atë kulturor. Leximi i librave ka qenë historikisht një nga shtyllat kryesore të formimit intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Megjithatë, në ditët e sotme, vërehet një rënie shqetësuese në nivelin e leximit, sidomos tek brezat e rinj.

Rëndësia e librit

Ushqen mendjen dhe imagjinatën

Libri është një dritare drejt botëve të reja, kulturave të ndryshme dhe përvojave që ndryshe do të mbeteshin të

thellësinë që ofron libri.

Çfarë mund të bëjmë për ta rikthyer leximin?

Të promovojmë leximin si kënaqësi, jo si detyrë. Të përdorim teknologjinë në favor të leximit, përmes librave elektronikë apo aplikacioneve për lexim. Të krijojmë hapësira publike dhe familjare që e nxisin leximin. Të ofrojmë modele frymëzuese, figura publike që lexojnë dhe flasin për libra.

Të rinjtë shqiptarë dhe libri: Një marrëdhënie që kërkon rindërtim

Leximi është një nga armët më të fuqishme të dijes dhe formimit personal. Por në kohën e teknologjisë, duket se të rinjtë po e braktisin atë. Cilat janë arsyet dhe si mund të rikthejmë këtë marrëdhënie? Në një kohë kur ritmi i

jetës është i shpejtë dhe informacioni konsumohet përmes ekraneve, libri duket sikur ka humbur betejën me vëmendjen e të rinjve shqiptarë. Fatkeqësisht, kjo prirej nuk kursen as brezat që hyjnë në radhët e Forcave të Armatosura. Në një institucion ku formimi moral, intelektual dhe profesional ka rëndësi të madhe, marrëdhënia me librin është më tepër se sa çështje personale, është çështje shërbimi.

Pse të rinjtë nuk lexojnë më?

Teknologjia si konkurrencë e fortë! Platformat digjitale ofrojnë përmbajtje të shpejtë, të thjeshtë dhe të “lehtë për tretur”. Ndërkohë, libri kërkon përqendrim, reflektim dhe kohë, tre gjëra që teknologjia na mëson t'i harrojmë.

Mungesa e kulturës së leximit! Shumë të rinj nuk e kanë përjetuar librin si mjet kënaqësie apo vetëformimi. Ai shpesh shfaqet si detyrë shkollore dhe jo si pasion. E pa këtë emocion, leximi nuk mbijeton gjatë.

Mungesa e modeleve frymëzuese! Të rinjtë kanë nevojë për shembuj që lexojnë, që flasin për libra, që frymëzojnë. Figura si prindërit, mësuesit apo udhëheqësit e tyre në Forcat e Armatosura mund të luajnë një rol kyç.

Vështirësia për të gjetur libra aktualë dhe të afërt me realitetin! Librat klasikë janë të vlefshëm, por të rinjtë kanë nevojë edhe për autorë që flasin për realitetin e sotëm, për sfidat, dilemat dhe vlerat me të cilat përballen në përditshmëri.

Leximi në shërbim të formimit ushtarak

Në Forcat e Armatosura, leximi është mjet i zhvillimit profesional dhe i thellimit të njohurive për histori, strategji, komunikim dhe lidhshmëri. Një ushtarak që lexon është më i përgatitur për të kuptuar kontekstin e detyrës së tij dhe për të marrë vendime të arsyetuara. Për më tepër, leximi

forcon karakterin.

Në libra gjenden histori që frymëzojnë, që mësojnë durimin, përkushtimin dhe ndjenjën e detyrës, vlera thelbësore për çdo pjesëtar të Forcave të Armatosura.

Çfarë mund të bëjmë për ta ndryshuar këtë realitet?

Të nxisim leximin jo si detyrë, por si pjesë e përditshme e formimit vetjak. Të krijojmë grupe leximi brenda institucioneve ushtarake – qendra edukimi, akademi, shkolla kadetësh, ku diskutohet për libra që lidhen me historinë ushtarake, vlera morale, apo sfida të kohës.

Të përdoret teknologjia në favor të leximit, libra digjitale, platforma edukative dhe biseda mbi libra në rrjete sociale.

Një investim që nuk humbet kurrë

Leximi është një prej atyre zakoneve që e shndërron njeriun në qytetar të denjë, profesionist të përgatitur dhe lider të mençur. Nëse duam breza ushtarakësh të formuar mirë, të vendosur në vlera dhe me vizion të qartë, duhet të rikthejmë librin në qendër të përgatitjes së tyre. Në fund të fundit, një libër i lexuar sot është një hap më afër një Shqipërie më të fortë nesër.

Për ata që sapo kanë hyrë në rrugëtimin sfidues ushtarak, vepra letrare të cilat sjellin mesazhe të forta dhe njëkohësisht pasqyrojnë histori dhe artin e Luftës në dimensionet e saj strategjike, do të ishin:

“Arti i Luftës” - Sun Tzu

Një klasik i mendimit strategjik, që mbetet aktual edhe në ditët e sotme. Ideal për të kuptuar parimet e udhëheqjes dhe luftës.

“Lufta dhe Paqja” - Leo Tolstoy

Një rrëfim i fuqishëm mbi realitetin e luftës, nderin, dashurinë dhe sakrificën. Një lexim që përmban thellësi historike dhe filozofike.

“Udhëheqja:Në kohë lufte dhe paqe” - James M. Kouzes & Barry Z. Posner

Një analizë moderne mbi lidhshmërinë që mund të aplikohet drejtpërdrejt në hierarkitë ushtarake dhe civile.

“Kalorësit e Skënderbeut” - Sabri Godo

Për të forcuar lidhjen me historinë kombëtare dhe figurën e një udhëheqësi ushtarak të jashtëzakonshëm shqiptar.

“Shoqëria e Spektaklit” - Guy Debord

Për të kuptuar ndikimin e medias dhe informacionit në shoqëri, një temë që lidhet ngushtë me sfidat moderne të sigurisë. Teknologjia po tjetëron formën dhe përmbajtjen e stilit të jetës, me shpejtësinë e dritës ne marrim informacionin e kërkuar, por ajo që duhet të mbetet e paprekur është dashuria mes humanit dhe librit, ku ‘gjithçkaja’ është universalja, unikja, mendimi i kuruar i profesionistit. Investimi më i mirë për një fëmijë është t'i falësh ‘botën e artë të librit’, dhe atëherë i ke dhënë rrugëtimin e sigurt të strategut të ardhshëm.



panjohura. Leximi zgjeron horizontet mendore dhe pasuron imagjinatën.

Zhvillon të menduarit kritik dhe analizën

Ndryshe nga informacioni i shpejtë dhe sipërfaqësor, që ofrojnë mediat sociale, libri kërkon reflektim dhe përfshirje intelektuale. Ai ndihmon në ndërtimin e një qëndrimi më të thelluar dhe racional ndaj çështjeve të ndryshme.

Rrit aftësitë gjuhësore dhe komunikimin

Leximi i rregullt përmirëson fjalorin, ndërtimin e fjalisë dhe kuptimin gjuhësor. Ai ndihmon gjithashtu në shprehjen më të saktë dhe më të bukur të mendimeve.

Ka vlerë terapeutike

Shpeshherë librat ofrojnë qetësi shpirtërore, ndihmojnë në përbalimin e stresit apo në gjetjen e përgjigjeve për dilemat jetësore.

Pse ka rënë leximi?

Dominimi i teknologjisë dhe mediave sociale/Shumë njerëz sot kalojnë orë të tëra në rrjete sociale, video të shkurtra dhe përmbajtje që ofrojnë argëtim të pa përpjekje intelektuale. Jetojmë në një epokë ku gjithçka kërkohet “tani dhe menjëherë”. Libri, si proces që kërkon kohë dhe përqendrim, nuk përshtatet me këtë mentalitet të përditshëm.

Mungesa e promovimit të leximit në shkolla dhe shoqëri. Në shumë sisteme arsimore, leximi nuk promovohet si një vlerë në vetvete, por si një detyrë. Po ashtu, edhe në familje, leximi nuk kultivohet që herët.

Zëvendësimi i librave me burime të lehta. Informacioni, artikujt online, videot përmbledhëse dhe përmbajtja digjitale kanë bërë që shumë të mendojnë se mund të “marrin të njëjtën njohuri më shpejt”, duke anashkaluar

Një britmë që dhemb më shumë se uria

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

- Përsëri oriz dhe vezë, nënë? Nuk e duroj më këtë varfëri! – bërtiti me zemërim.

E ëma u trondit nga britma, luga i ra nga dora që i dridhej, uli kokën, duke u përpjekur të fshehte turpin.

- Është e vetmja gjë që kemi, biri im... – pëshpëriti thujase pa zë.

Djali e përplasi pjatën me forcë mbi tavolinë, orizi u shpërnda në dysheme, disa kokrra u ngjiten në fytyrën e nënës.

- Epo mirë, haje vetë këtë ndyrësi! – bërtiti ai, duke i kthyer shpinën.

Ajo nuk tha asgjë. U përkul, e dridhur dhe nisi të mbledhë me gishta kokrrat nga dyshemeja. Si dikush që përpiqet të shpëtojë çfarë pak i ka mbetur... nga ushqimi dhe dinjiteti.

Ai shkoi në dhomën e tij. Ajo u gjunjësua, si çdo natë, pranë shtratit dhe u lut për të. Por djali nuk ndjente më dashuri. Nuk shihte më vlerë te ajo. Ditë më pas, u ngrit dhe tha:

- Po iki. Jam lodhur nga kjo jetë e mjerë. Po shkoj në qytetin e madh. Dua diçka më të mirë.

Ajo nuk e luti të qëndronte, nuk qau, por me zemër të thyer ia kapi dorën fort dhe i tha: - Premtomë që do t’u përgjigjesh thirrjeve të mia. Të lutem, biri im... Të lutem. Ajo lutej. Ai ngriti sytë nga qielli. Atëherë ajo shtoi me zë të dobët: - Jam shumë e lodhur... ndjej që koha ime po mbaron. Ditën kur të ndaloj së të telefonuari... do të jetë sepse jam larguar tashmë. Ai as nuk e përshëndeti siç duhej.

Qyteti i madh nuk ishte siç e kishte imagjinuar, punonte ku të mundte: ngarkonte kuti, ruante një diskotekë, përziente çimento në kantier, ushqimi mungonte, paratë edhe më shumë.

Por çdo ditë telefoni binte. Ishte nëna e tij: - Përshëndetje, biri im... Je mirë? - Jam i zënë, nënë. Dhe ia mbyllte, i zemëruar, me nxitim. Derisa një ditë telefoni nuk ra. Dhe heshtja...bërtiti.

E shikoi aparatin gjithë ditën. Erdhi nata dhe mendoi me vete: “Ajo ka vdekur.”

Nuk qau. Nuk u përpoq ta telefononte. As nuk u mundua të shkonte në varrim. Nuk kishte para. Dhe sikur të kishte... nuk do të shkonte. Kaluan ditët. Dhe ai e dinte: nëna e tij nuk ishte më gjallë. Muaj më vonë, i rraskapitur nga mjerimi, pranoi një ofertë: - Janë para të lehta. Thjesht duhet të ngasësh makinën - i tha një i njohur i tij. Makina ishte plot me drogë. E dinte. Por pranoi. Donte të ngjitej në jetë... shpejt. Atë natë hipi në makinë, rregulloi sediljen, vendosi duart mbi timon... Dhe telefoni vibroi. Numër i panjohur. U përgjigj. - Biri im... Të lutem, mos shko. Mos e bëj këtë udhëtim. Kthehu mbrapsht. Hiq dorë nga kjo ide. Tani! Zëri... ishte i saj. Zemra iu drodh. - Nënë!? Je gjallë?

- Të lutem, biri im. Më dëgjo. Kthehu në shtëpi. Dhe... kujdesu për veten.

Dhe ajo ia mbylli në fytyrë. Ai u përpoq ta telefononte. Por dëgjoji një mesazh të ftohtë: “Numër që nuk ekziston”. Zbriti nga makina, i djersitur. Gjoksi i shtrënguar. Shiti çfarë kishte. Disa rroba. Një palë këpucë. Bëri shitje rrugës dhe mblodhi aq sa për të kthyer mbrapsht.

Kur mbërriti, rruga ishte më e heshtur se zakonisht. Fqinjët e shikonin me keqardhje.


- Nëna jote ka vdekur një muaj më parë... Ra në trotuar, pa fuqi.

- Nuk është e mundur... Më telefonoi dje! Foli me mua! - E pamundur. Ajo ka vdekur prej kohësh biri im, - i tha gjitoni i tij.

Hyri në shtëpi. Në dhomë ndjehej ende aroma e saj. Në dhomë, heshtja dhembte.

Pranë shtratit, shenja gjunjësh në dysheme. Ajo gjunjëszohej aty çdo ditë... për t’u lutur për të. Në një qoshe, një listë lutjesh. Emri i tij ishte në krye, i shënuar ditë pas dite.

Që kur u largua...deri në ditën e fundit para vdekjes së saj. Ai u gjunjësua aty, duart i dridheshin, lotët i rridhnin pa ndalesë.



Vrapoi në kuzhinë, lau fytyrën në lavaman... dhe e pa.

Mbi tavolinë, një fletë e palosur. Nuk ishte letër. Ishte një lutje e shkruar me dorën e saj: “Zot, po ndjej vdekjen pranë. Dhe nëse vdes, nuk do të mund të lutem më për djalin tim. Prandaj... ta dorëzoj Ty. Nëse ndonjë ditë është në rrezik, të lutem, njoftoje. Thirr në këtë numër”. Dhe aty ishte numri i tij. Në atë çast, telefoni vibroi.

Njoftim në lajme: “Makina e shpuar nga plumbat. Shoferi i vdekur. Ngarkesa e humbur”. Fotoja... ishte e makinës që duhej të ngiste atë natë. Ra në gjunjë dhe kuptoi. Thirrja... erdhi nga qielli. Zoti përdori lutjen e fundit të një nëne për të shpëtuar një bir mosmirënjohës.

“Lutja e Nënës”

Lutja e Nënës, që ndonëse e heshtur dhe e thjeshtë, mbetet forca më e pastër dhe më besnike që një njeri mund të ketë në jetë. Pavarësisht fyerjeve, dhimbjes dhe neglizhencës, ajo kurrë nuk ndalet së dashuri dhe luturi për birin. Është dashuria e pakushtëzuar e nënës, që qëndron si një shtyllë morale dhe shpirtërore në jetën e të birit, pavarësisht se ai nuk e vëren këtë derisa është tepër vonë.

Mosmirënjohja ndaj prindërve – plagë e heshtur

Fëmija, i lodhur nga mungesat, i frustruar nga realiteti që nuk përputhet me dëshirat e tij, ngre zërin, jo kundër ushqimit, por kundër gjendjes së vet, ndoshta edhe kundër fatit. Por zëri i ngritur nuk bie mbi sistemin, mbi shtetin, mbi padrejtësitë e jetës, ai bie mbi supet më të lodhur dhe më të dashur, të nënës.

Nëna, ajo që çdo ditë zgjohet më herët se të gjithë, që mirëqenien e saj e mat me buzëqeshjen e fëmijëve, që ha pjesën e fundit të bukës vetëm nëse fëmijët janë ngopur. Ajo që kur nuk ka, ‘e gjen’, dhe kur nuk mundet, kërkon një mënyrë. Dhe kur

e pamundura mbetet e tillë, i mbulon me një përqaftim, sepse nëna nuk jeton për vete, por për të tjerët.

Nëna është i vetmi njeri në botë që ka forcë të buzëqeshë, edhe kur zemra i qan, dhe kur fëmija i saj, ai që ajo e ka mbajtur në bark, e ka ushqyer me qumështin e vet, e ka mbuluar me trupin e saj kur s’kishte as batanije, kur ai e flet me zë të lartë, e qorton, e fajëson, ajo thjesht hesht. Dhe në atë heshtje, nuk ka zemërim, ka dhimbje, ka trishtim, ka lot të pathënë.

Ndodh... Jo vetëm në një krijim letrar, por çdo ditë, në shumë familje. Sepse uria nuk është vetëm bukë, është edhe jetë më e mirë, dinjitet, socializim. Dhe kur shpresa nuk përmbushet, fajin e kërkojmë aty ku nuk duhet, te njeriu që ka sakrifikuar gjithçka për ne. Shoqëria moderne i nxit të rinjtë të jenë ambiciozë, të kërkojnë sukses, të duan më shumë. Por, askush nuk i mëson si të jenë mirënjohës. Askush nuk i ndalon për t’i thënë: “A e falënderove nënën sot që është ende aty, me atë lugë që i bie nga dora e lodhur?”. Sepse kur ajo lugë të mos jetë më, atëherë ndoshta do të dëshirojmë edhe njëherë orizin dhe vezën që dikur ngjallte zemërim, jo për shijen, por për kujtimin.

Në themel të çdo shoqërie të shëndoshë qëndron familja, ndërsa në zemrën e familjes qëndron nëna, figura më e ndritshme dhe më e përkushtuar në jetën e çdo individi. Megjithatë, sot, në një kohë kur vlerat morale po

përballen me sfida të reja, gjithnjë e më shpesh jemi dëshmitarë të një fenomeni të dhimbshëm: mosmirënjohjes ndaj prindërve. Ky realitet i hidhur përbën një plagë të thellë shoqërore dhe shpirtërore, e cila nuk duhet të neglizhohet.

Mosmirënjohja nuk lind papritur. Ajo është rezultat i një shoqërie që po humb kontaktin me vlerat njerëzore, që vlerëson më shumë suksesin personal sesa mirësinë, që i jep përparësi pasurisë materiale në vend të lidhjeve shpirtërore. Të rinjtë, të zhytur në teknologji e ambicie të shpejta, harrojnë të ndalojnë për një moment dhe të kujtojnë duart që i ushqyen, sytë që i përcollën me lot dhe zemrën që i deshi pa kushte. Nëna nuk kërkon shumë. Ajo nuk pret shpërblime apo lëvdata. Asaj i mjafton një përqaftim i ngrohtë, një fjalë falënderimi, një gjest i vogël dashurie. Kur as kjo nuk ndodh, kur ftohtësia dhe harresa mbulojnë çdo kujtim, ajo hesht. Dhe në këtë heshtje fshihet dhimbja më e madhe, ajo e një zemre të lënduar nga ata që i dha jetën. Një shoqëri që nuk respekton prindërit është një shoqëri pa rrënjë, një shoqëri që ecën drejt zhveshjes së saj nga humanizmi. Mosmirënjohja ndaj nënës është më shumë se një mungesë respekti, është një tradhti ndaj vetvetes, ndaj kujtesës dhe identitetit tonë. Është koha të rikthejmë mirësinë, përlulesinë dhe vlerësimin për ata që na kanë formuar si njerëz. Sepse vetëm atëherë kur do të nderojmë nënën, kur do të kujtojmë sakrificën e saj me zemër të hapur, do të jemi të denjë për të qenë bij të saj dhe qytetarë të vërtetë të një bote më të mirë. Njerëz, në një botë ku gjithçka mund të zëvendësohet, nëna është e pazëvendësueshme. Nëse dëshirojmë të kemi një të ardhme të ndritur si individë dhe si shoqëri, duhet të fillojmë duke e nderuar dhe respektuar nënën, jo vetëm me fjalë, por me vepra. Sepse mosmirënjohja ndaj saj nuk është thjesht mungesë edukate, është mungesë shpirti.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të pathënat e një rrugëtimi: Gruaja shqiptare dhe sfidat e kohës

Gratë shqiptare kanë një kombinim të veçantë tiparësh kulturore, historike dhe shpirtërore, që i bëjnë të dallueshme në shumë aspekte krahasuar me gratë e vendeve të tjera.

Trashëgimia kulturore dhe roli në familje

Gratë shqiptare janë rritur në një shoqëri ku familja zë vend qendror. Ato shpesh janë shtylla kryesore e familjes, jo vetëm në rolin tradicional si nëna apo bashkëshorte, por edhe si udhëheqëse morale dhe shpesh ekonomike. Kjo ndikon në forcimin e karakterit dhe ndjenjën e përgjegjësisë.

Forca dhe qëndresa në kushte sfiduese

Historikisht, gratë shqiptare janë përballur me sfida të mëdha: nga varfëria, luftërat, tranzicioni i pas-komunizmit, deri te migrimi dhe diskriminimi gjinor. Por këto kushte i kanë formuar si gra të forta, të përballueshme dhe me një instinkt të thellë mbijetese.

Zëri i ri në shoqëri dhe politikë

Në dekadat e fundit, gratë shqiptare po marrin gjithnjë e më shumë hapësirë në politikë, media, art dhe akademi. Ky është një transformim që po ndodh në një ritëm shumë të shpejtë krahasuar me vende të tjera me sfond të ngjashëm kulturor. Kjo tregon një potencial të madh për ndryshim dhe udhëheqje progresive.

Identiteti dy-kulturor (për gratë e diasporës)

Shumë gra shqiptare që jetojnë jashtë vendit kanë mësuar të balancojnë mes kulturës shqiptare dhe kulturës së vendit ku jetojnë. Kjo u jep atyre një perspektivë të gjerë ndërkulturore, e cila është aset i madh në çdo fushë – nga biznesi te arti.



Mira Murati,
gruaja pas
ChatGPT. Gjeniu
shqiptar është
truri teknologjik
dhe njerëzor që
qëndron pas AI.
Ajo doli më e fortë
nga betejat për
pushtet brenda
kompanisë.

Zgjuarsia dhe ambicia

Shumë studime dhe vlerësime sociale në Shqipëri, tregojnë se vajzat shqiptare kanë rezultate më të larta akademike se djemtë në nivelet parauniversitare dhe universitare. Ato janë shpesh më të motivuara për të ecur përpara dhe për të ndryshuar fatin e vet dhe të familjes së tyre.

Ndjenja e thellë e përkatësisë dhe ruajtja e identitetit

Edhe në mërgatë, gratë shqiptare shpesh janë ruajtëse të traditës, gjuhës dhe zakoneve. Ato kanë një lidhje të fortë me rrënjët, që nuk shuhet edhe kur jetojnë larg.

Ajo që e bën gruan shqiptare të veçantë është aftësia e saj për të qenë e shumëfishtë në një trup të vetëm: tradicionale dhe moderne, e butë dhe luftëtare, e heshtur por me ndikim, me rrënjë të thella dhe krahë të hapur drejt botës.

Arritjet e gruas shqiptare janë të shumta dhe gjithnjë në rritje, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Këto arritje nuk janë vetëm personale, por shpesh përfaqësojnë përparim të shoqërisë shqiptare drejt barazisë, zhvillimit dhe modernizimit. Ja disa nga arritjet më të mëdha të gruas shqiptare:

Përfaqësimi në politikë dhe institucione

Atifete Jahjaga u bë presidentja e parë femër në historinë e Kosovës dhe një nga lideret më të njohura të Ballkanit.



Mimoza Kusari-Lila, dhe shumë gra të tjera kanë mbajtur poste të larta në qeveri dhe institucione ndërkombëtare.

Në zgjedhjet e fundit në Shqipëri, përqindja e grave në Kuvend është rritur ndjeshëm, falë kuotave gjinore dhe angazhimit aktiv të grave në politikë.

Suksesi në arsim dhe shkencë

Gratë shqiptare dominojnë në shumë programe universitare, veçanërisht në fushat e mjekësisë, farmaceutikës, arsimit dhe gjuhësisë.

Shumë gra janë bërë profesore, kërkuese shkencore dhe drejtore institucionesh akademike në universitete brenda dhe jashtë vendit.

Disa kanë kontribuar në studime të rëndësishme ndërkombëtare në bioteknologji, sociologji dhe teknologji informative.

Suksesi në sport

Luiza Gega nuk njeh më limite me rezultatet e saj, përfaqësuesja e Forcave të Armatosura siguroi rezultatin më të mirë në historinë e atletikës shqiptare.

Majlinda Kelmendi bëri histori si kampione olimpike në xhudo për Kosovën në “Rio 2016”.

Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi gjithashtu kanë sjellë medalje të arta në garat më të mëdha ndërkombëtare.

Vajzat shqiptare janë përfaqësuar me dinjitet në sporte si atletika, noti,

futbolli dhe volejboli.

Arritje në art dhe kulturë

Dua Lipa është një nga yjet më të mëdhenj të muzikës pop në botë.

Rita Ora, Inva Mula, Eliza Dushku, dhe shumë artiste të tjera shqiptare kanë arritur famë ndërkombëtare në muzikë, film dhe art skenik.

Në letërsi dhe poezi, emra si Luljeta Lleshanaku kanë fituar çmime ndërkombëtare.



Gratë në biznes dhe sipërmarrje

Gjithnjë e më shumë gra shqiptare po themelojnë biznese të suksesshme, duke sjellë inovacion në fusha si teknologjia, moda, turizmi dhe bujqësia e qëndrueshme.

Gratë janë gjithashtu gjithnjë e më shumë aktive në startup-et teknologjike, veçanërisht në diasporë.

Angazhim në shoqëri civile dhe të drejtat e njeriut

Gratë shqiptare kanë qenë në pararojë të luftës për barazi gjinore, të drejtat e njeriut, fuqizimin ekonomik dhe kundër dhunës me bazë gjinore.

Organizatat e drejtuar nga gra kanë ndikuar ndjeshëm në legjislacion dhe në ndërgjegjësimin publik.

Roli në diasporë

Në mërgatë, gratë shqiptare kanë arritur suksese të mëdha në arsim, shëndetësi, teknologji dhe qeverisje lokale. Ato janë ura lidhëse midis kulturës shqiptare dhe komuniteteve ndërkombëtare.

Këto arritje janë prova se gruaja shqiptare nuk është më vetëm pjesëmarrëse në histori, ajo është krijuese e saj.





Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Muhamet Shehu (1930-1967), dha jetën për mbrojtjen e pasurisë së përbashkët 'Hero i Punës Socialiste'. Lindi në fshatin Bicaj të Kukësit në një familje të lidhur ngushtë me LANÇ. Në moshën 13-vjeçare mori pjesë në radhët e Ushtrisë NÇ. Pas Çlirimit kreu studimet e larta për inxhinier naftë dhe punoi në sektorë të ndryshëm të industrisë së naftës, ku u dallua për punë të palodhur dhe aftësi profesionale. Ra në krye të detyrës, së bashku me shokun e tij të punës, Myrteza Kepi, në përlëshje me flakët e një zjarri të fuqishëm që shpërtheu në stacionin e pompimit të naftës të Linasit, në rrethin e Elbasanit, më 15.2.1967. Akti i tij heroik u bë shembull i lartë frymëzimi për gjithë punonjësit e vendit.

Heroi i Popullit Muhamet Shehu, la pas familjen e tij të nderuar, ku kontribut të çmuar ka dhënë dhe vajza e tij Luiza Shehu (Filaj). Kontributi në strukturën e rendit dhe sigurisë publike në polici nuk është privilegj, por përgjegjësi. Policia që në kohën që u krijua e në vijimësi ka kërkuar dhe kërkon mund e djersë, përkushtim, sakrificë të panumërta. Duhet të depërtosh në "lëkurën" e kësaj strukture ta njohësh, ta prekësh, ta ndjesh përditshmërinë e sakrificave, punën e madhe për t'iu siguruar njerëzve qetësinë, rendin e sigurinë. Këtë e ka treguar më së miri dhe kontributi i Kryekomisare Luizës.

Jetën e saj, Luiza e ngriti me djersë, sakrificë, mundim e ndershmëri, ofroi profesionalizmin dhe sfidoi vështirësitë.

Fillim prilli i vitit 2025 është stacioni i ri i shkëputjes nga radhët e Policisë së shtetit për Luizën, i cili meriton mirënjohje, për çdo ditë kontribut të saj.

Ndaj, mjedisi shoqëror ku ka punuar Kryekomisare Luiza shpreh pa rezerva mirënjohje një ndjenjë falënderuese, një virtut që pasuron ata që e shfaqin dhe lumturon atë që i adresohet.

Luiza Shehu (Filaj) është lindur më 7.6.1963 nga një nënë e dashur dhe e përkushtuar. Arsimin fillor e tetëvjeçar, i përfundoi me rezultate të larta dhe vijoi Shkollën e Mesme Tregtare në Vlorë (1978-1982). Arsimin e lartë e ka kryer në Fakultetin Ekonomik UT, me rezultate shumë të mira. Karriera policore e saj ka nisur me funksionin: Ekonomiste në prapavijë në Drejtorinë e Rendit Publik Tiranë dhe më tej, Ekonomiste plani në drejtorinë e Policisë së Tiranës. Specialiste e programim buxhetimit KP 3; Specialiste prokurimesh në Drejtorinë e Policisë së Tiranës; Shefe Sektori dhe specialiste në Sektorin e Trajnimit në Drejtorinë e Personelit; Specialiste për koordinim në Departamentin e trajnimit, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e shërbimeve mbështetëse në DPPSH; Specialiste në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Nga viti 2022 e në vijim, përreth tre vite ka shërbyer si specialiste e Kërkimit Shkencor në Sektorin e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Inovacionit në QKSHP, në Akademinë e Sigurisë. Në hierarkinë e karrierës policore ka pasur këto grada: oficer, kapitene, kapiten i parë, kryeinspektore, kryekomisare dhe sërish kryekomisare me riorganizimin e vitit 2016. Arsimimi i vazhdueshëm ka qenë për specialisten e Policisë në më shumë se dy dekada, për gjuhën angleze për trajnim policor, për sistemin Cyberworks, disa kurse për zhvillimet profesionale të femrave në polici, për trajnimin e trajnerëve, për menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe disa trajnime policore të viteve 2012-2013. Ajo ka merituar respekt dhe mirënjohje në të gjitha detyrat që ka kryer. Por vlerësimin e parë mirënjohës në Polici e ka marrë në Akademinë e Sigurisë në vitin 2024, me motivacion: "Për punë të ndërgjegjshme dhe me korrektesë në kryerjen e detyrave të ngarkuara në funksion të përmbushjes së misionit dhe përgjegjësi në çdo detyrë që ka kryer në shërbim të Policisë së Shtetit". Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ilir Proda, i ka akorduar gjithashtu Certifikatën e Karrierës, "Për merita të veçanta, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar për përmbushjen e detyrave dhe kontributin e dhënë gjatë viteve të punës, në shërbim të Policisë së Shtetit".

Që prej korrikut 2022, ka punuar pranë Akademisë së Sigurisë si specialiste në Sektorin e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Inovacionit. Kryekomisare Luiza Filaj nuk pranon vlerësime e

NGA SAKRIFICA TE SHËRBIMI AMANETI I NJË DËSHMORI NË ZEMRËN E VAJZËS QË MBRON ATDHEUN



lëvdata, as shkrime. Ajo mbetet e thjeshtë, njerëzore, e përkushtuar ndaj familjes, nënës, mbesës, një personalitet-vlerë për shoqërinë policore, pasi kudo ku ka punuar në strukturën e Policisë ka mbetur etalon i mirësisë njerëzore, korrektesisë dhe përkushtimit në punë. Ajo u bë e njohur në QKSHP, në Sektorin e Kërkimit Shkencor, që kishte një kulturë të pasur pune, që gjithë jetën në organizatën e Policisë e kishte si një testament korrektesie si shtetare. Fakt është se ajo ka qenë modeli frymëzues për brezat e rinj të Policisë së Shtetit,



HEROI I POPULLIT MUHAMET SHEHU, LA PAS FAMILJEN E TIJ TË NDERUAR, KU KONTRIBUT TË ÇMUAR KA DHËNË DHE VAJZA E TIJ LUIZA SHEHU (FILAJ). KONTRIBUTI NË STRUKTURËN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE NË POLICI NUK ËSHTË PRIVILEGJ, POR PËRGJEGJËSI. POLICIA QË NË KOHËN QË U KRIJUA E NË VIJIMËSI KA KËRKUAR DHE KËRKON MUND E DJERSË, PËRKUSHTIM, SAKRIFICA TË PANUMËRTA.

edhe pse mosha biologjike është vetëm çështje numrash. Puna e saj e papërtuar, mbështetja për të rinjtë, përveshja vullnetare e mëngëve, duke mos u tërhequr kurrë para asnjë vështirësie ishte dhe ngelet imazhi i veprimit pozitiv për Policinë dhe sidomos për Akademinë e Sigurisë ku punoi pothuaj tre vitet e fundit. Njerëzit që e kanë ushqyer shpirtin me punë, pa hile kanë lënë gjurmë thjeshtësie dhe ndershmërie. Kryekomisare Luiza bën pjesë në njerëzit e mençur që ka shërbyer se "na bashkon urdhri", por ka qenë dinjitoze dhe krenare për punën dhe jetën, që ka ditur të përballët dhe përballojë sfidat. Bashkëpunëtorët në organizatën e Policisë janë krenarë që kanë pasur një kolege me vlerë, që bën pjesë në asetet që nuk e mposhtën vështirësitë. Ata përbashkohen në një zakon-ritual institucional të respektimit në ditët kulmore jetësore sikurse është edhe dita e pensionimit, duke e shndërruar këtë ditë në ditë gëzimi të veçantë.

Është fakt se kryekomisare Luiza ofron si gjithmonë optimizëm shoqëror e familjar, ka qenë "e dënuar", të ofrojë ekspertizë veçanërisht në fushën ekonomike, në strukturat mbështetëse të DPPSH. Është kjo arsyeja që "mosha biologjike" e pensionimit nuk ekziston, pasi vlerat e Policisë janë gjithmonë bashkë në çdo frymëmarrje e zhvillim progresiv të policisë. Shkëputja nga institucioni është thjesht një "urdhër", pasi uniteti njerëzor shkon përtej urdhrave. K/komisare Luiza Filaj ishte dhe ngelet shpirtërisht e lidhur me organizatën e Policisë. Koha bën të vetën, ec, nuk ndalet. Jeta rrjedh, por nuk ka skenar që të "thyejë" shpirtat njerëzorë, gëzimin dhe lidhjen me institucionin, edhe pse vijueshmëria e hobeve personale e familjare drejt eksplorimit të shtigjeve malore, bukurive të peizazheve shqiptare, por dhe bregdetit e peshkimit, natyrshëm do të vijojnë, edhe me më shumë kohë në dispozicion. Urdhri respektohet e zbatohet "zyrtarisht" sikurse vjen "zyrtarisht", mirëpritet në respekt të ligjit, edhe përtej dëshirave. Kur urdhri përputhet me dëshirat dhe pritshmëritë, rritet qetësia e lumturia njerëzore familjare, rritet angazhimi familjar dhe përkujdesja prindërore edhe si nënë edhe si gjyshe. Njerëzit e zakonshëm të policisë ndihen krenarë për vitet nën uniformë, ndjehen krenarë për jetën e jetuar njerëzisht, me përkushtim si shtetarë seriozë në familjen e madhe të përbashkët të rendit dhe sigurisë publike, gjithmonë për detyrën-nderin-Atdheun. Miqtë, kolegët, bashkëpunëtorët në rrugëtimin e gjatë në strukturat e Policisë së Shtetit i urojnë Kryekomisare Luizës shëndet dhe jetë të gjatë! Përbashkohet në këtë urim gjithë organizata e madhe e Policisë.

Çështjet aktuale globale që duhet të adresojmë

Në një epokë përparimesh të jashtëzakonshme dhe lidhjeve të pashembullta, bota vazhdon të përballet me një sërë sfidash të thella që i kapërcejnë kufijtë. Këto probleme globale, duke filluar nga ndikimet shkatërruese të ndryshimeve klimatike deri te spektri i vazhdueshëm i varfërisë dhe pabarazisë, kërcënojnë jo vetëm përparimin që ka arritur njerëzimi, por edhe vetë strukturën e ekzistencës sonë të përbashkët. Mes potencialit për zgjidhje novatore qëndron ndërgjegjësimi i kthjellët se adresimi i këtyre çështjeve kërkon veprim kolektiv, mendim inovativ dhe një angazhim të palëkundur për barazi dhe qëndrueshmëri.

Ndërlidhja e këtyre sfidave është e pamohueshme. Ndryshimet klimatike nxisin fatkeqësitë natyrore që shkatërrojnë komunitetet e cënueshme, duke përkeqësuar pasigurinë ushqimore dhe duke zhvendosur miliona. Pabarazitë ekonomike thellojnë ndarjen midis të privilegjuarve dhe të marginalizuarve, duke gërryer kohezionin social dhe duke penguar përpjekjet për të krijuar një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Ndërkohë, përparimet teknologjike, ndonëse transformuese, paraqesin grupin e tyre të dilemave - automatizimi kërcënon jetesën dhe ndarja dixhitale lë miliona pa akses në burimet thelbësore. Ndërsa komuniteti global lundron këto kompleksitete, thirrja për veprim është e qartë: njerëzimi duhet të bashkohet në trajtimin e këtyre problemeve të përbashkëta për të ndërtuar një të ardhme elastike, të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë.

Varfëria

Mosbalancimi në ekonomi dhe ekzistenca e varfërisë mes pasurisë ekstreme mund t'i atribuohet disa faktorëve strukturorë, historikë dhe sistematikë. Ndërsa përparimet teknologjike dhe globalizimi kanë nxitur rritjen ekonomike, ato gjithashtu kanë thelluar pabarazitë.

Shkaqet e Çekuilibrit Ekonomik dhe Varfërisë

Pabarazia historike: Shumë rajone filluan ekonomitë e tyre moderne nën sistemet koloniale ose strukturat shfrytëzuese që përqendruan pasurinë në duart e disave dhe lanë popullsi të mëdha që luftonin për burime. Ciklet brez pas brezi të varfërisë vazhdojnë në komunitetet që historikisht ishin të përjashtuara nga mundësitë e krijimit të pasurisë.

Shpërndarja e pabarabartë e pasurisë: Miliarderët shpesh grumbullojnë pasuri përmes investimeve, fitimeve kapitale ose praktikave monopoliste. Sistemet e taksave në shumë vende nuk e rishpërndajnë në mënyrë adekuate këtë pasuri për të adresuar nevojat e shoqërisë. Krijimi i pasurisë në industri të tilla si financa dhe teknologjia përfiton në mënyrë disproporcionale ata me kapital dhe burime ekzistuese, duke e zgjeruar hendekun.

Sistemet Ekonomike: Kapitalizmi i tregut të lirë inkurajon suksesin individual, por jo gjithmonë ofron masa mbrojtëse për shpërndarje të barabartë. Shumë ekonomi i japin përparësi fitimit mbi mirëqenien sociale. Politikat si subvencionet për korporatat e mëdha ose boshllëqet tatimore e përkeqësojnë më tej çekuilibrin.

Akresi në burime dhe mundësi: Akresi i pamjaftueshëm në arsim cilësor, kujdes shëndetësor dhe punësim të qëndrueshëm i bllokoi komunitetet në varfëri, duke parandaluar lëvizshmërinë në rritje. Pabarazitë gjeografike, të tilla si zonat rurale kundrejt atyre urbane, kufizojnë mundësitë për popullsi të caktuara.

Konsumerizmi dhe ekstravaganca: Ndërsa shpenzimet e miliardërve për sende luksi mund të duken të tepërta, pasuria e tyre teorikisht mund të financojë projekte të rëndësishme sociale. Megjithatë, barrierat sistemike pengojnë rishpërndarjen efektive.

Mënyrat për të adresuar problemin

Taksimi progresiv: Vendosja e taksave më të larta për të pasurit dhe mbyllja e boshllëqeve tatimore mund të gjenerojë të ardhura për shërbimet publike dhe zbutjen e varfërisë.

Investimi në arsim dhe kujdes shëndetësor: Ofrimi i arsimit të aksesueshëm, me cilësi të lartë dhe kujdesit shëndetësor universal krijon shtigje për individët për t'i shpëtuar varfërisë.



Përgjegjësia e korporatës: Inkurajimi i kompanive për të miratuar iniciativa me ndikim social mund të sigurojë që gjenerimi i pasurisë të kontribuojë në zhvillimin e komunitetit.

